



Datë: 05.05.2025
Numër Protokoli: 3385/2025

A.nr.419/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosje e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari- anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.419/2025 të datës 05.03.2025 të parashtruar nga ankuesja S.B, me përfaqësues të autorizuar avokat Latif Hyseni, kundër organit të punësimit/Akademia e Kosovës për Siguri Publike në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës; duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, me datë 05.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.419/2025 e datës 05.03.2025 e parashtruar nga ankuesja S.B.

A r s y e t i m

Ankuesja S.B, (tutje referuar vetëm ankuesja), më datë 18.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes përfaqësuesit të autorizuar avokat Latif Hyseni, me pretendimet ankimore përmes autorizimit të datës 18.04.2013, të nxjerr nga Menaxheri i Personelit i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, jam autorizuar që të krye detyrat e punës për pozitën Zyrtare e Arkivit, po ashtu ankuesja ka pretenduar që të nxirret Akt Emërimi, në bazë të detyrave të punës Zyrtare e Arkivit, të përfshihet në sistemimin e pagave të gëzojë pagën/ benifitet sipas pozitës Zyrtare e Arkivit .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 12.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Akademia e Kosovës për Siguri Publike, ndërsa kjo e fundit, më datë 13.03.2025 ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Me tej Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me vendim me numër protokoli 2519/2024, të datës 16.04.2024, ka zgajtur afatin edhe për dhjetë (10) ditë pune lidhur me ankesën e ankueses S.B.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1456/2025 të datës 05.03.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 04.02.2024, nga S.B, për L.H; Kopje e letërnjoftimit për S.B; dëshmi nga Posta e Kosovës; Kontrata e marrëdhënies së punës me numër protokolli 17/6, e datës 28.01.2014, për S.B; Kontrata e marrëdhënies së punës me numër protokolli 199/7 e datës 28.12.2012, për S.B; Kontrata e marrëdhënies së punës me numër protokolli 714, e datës 03.05.2011, për S.B; Autorizimi i datës 18.04.2011, i nxjerr nga Menaxheri i Personelit i Akademisë së Kosovës për Siguri Publik, për S.B; Akt Emërimi me numër protokolli 123, i datës 18.04.2014; PAGESA për periudhën nga data 01.11.2024, deri me datën 30.11.2024; Formuari për vlerësimin e rezultateve në pune i vitit 2023, për ankuesen S.B; Formuari për vlerësimin e rezultateve në pune i vitit 2022, për ankuesen S.B; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 12.03.2025, dërguar përmes emailit nga R.K, për Xh.K; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 419/2025, e datës 13.03.2025; Përshkrimi i Detyrave të Punës për pozitën Receptonit; Formuari për vlerësimin e rezultateve në pune i vitit 2025, për ankuesen S.B.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është e **pabazuar**, sepse:

Nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja sipas Akt Emërimit me Nr. 123 të datës 18.09.2014 është e punësuar në pozitën Receptoniste në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Tutje, Menaxheri i Personelit i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, më datë 18.04.2013, përmes emailit ankuesen nga pozita Receptoniste, e ka autorizuar ti kryej detyrat e punës për pozitën ‘‘Zyrtare e Arkivit’’.

Ankuesja, përmes të autorizuarit avokatit Latif Hyseni më datë 08.12.2024, i është drejtuar Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Akademinë e Kosovës për Siguri Publik, duke kërkuar që të nxirret Akt Emërim në bazë të përshkrimit të detyrave të punës që kryen për pozitën Zyrtare për Arkiv, të përfshihet në sistem të pagesave financiare dhe të gëzoj pagën sipas pozitës detyrës që kryen me detyrat Zyrtare për Arkiv, dhe atë në mënyrë retroaktive nga vitit 2013, deri në parashtrimin e ankesës në Këshill.

Më datë 05.03.2025 ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore së përmes autorizimit të datës 18.04.2013, të nxjerr nga Menaxheri i Personelit i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, jam autorizuar që të krye detyrat e punës për pozitën Zyrtare e Arkivit, po ashtu ankuesja ka pretenduar që të nxirret Akt Emërimi, në bazë të detyrave të punës Zyrtare e Arkivit, të përfshihet në sistemimin e pagave të gëzojë pagën/benefitet sipas pozitës Zyrtare e Arkivit.

Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja përmes emailit të datës 18.04.2013, të nxjerr nga Menaxheri i Personelit i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, nga pozita Receptonist është autorizuar ti kryej detyrat e punës Zyrtare e Arkivit, dhe se nga data 22.04.2013, lirohet nga detyrat e punës nga pozita paraprake, dhe se kryerja e detyrave të punës do të behët në bazë të përshkrimit të detyrave të punës të lëshuar nga Njësia e Personelit, dhe me vlerën e njëjtë të pagës, nga pozita paraprake, dhe se konform strukturës organizative të Akademisë drejtpërdrejt i përgjigjet Shefit të Sektorit të Logjistikes, duke i dhënë Këshillin Juridike që në afatin prej 5 ditësh pala e pakënaqur të parashtojë ankesë tek Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se autorizimi i ankueses nga Menaxheri i Personelit i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për ti krye detyrat e punës për pozitën “ Zyrtares e Arkivit”, nga pozita Receptionsist, është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, nenin 11 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcakton se: „Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve, ndërlidhur me nenin 18, paragrafi 1, të Ligjit nr. 03/L-14 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se; 1. Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës, ndërsa në rastin konkret kjo pozitë është bërë me autorizimin pa zhvillimin e procedurave të rekrutimit në kohën kur ankuesja është autorizuar nga Menaxheri i Personelit i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për ti krye detyrat e punës për pozitën “ Zyrtares e Arkivit”, dhe kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Lidhur me pretendimin ankimore të ankueses, e cila pretendon që të nxirret Akt emërim në bazë të përshkrimit të detyrave të punës që kryen për pozitën Zyrtares për Arkiv, dhe se ankuesja duhet të përfshihet në sistemin e pagesave financiare dhe të gëzoj/ benifitet sipas pozitës që kryen në detyrat e punës dhe atë në mënyrë retroaktive për vite të tera që është diskriminuar pa të drejtë, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të pa bazuar në ligj, sepse autorizimi nga Menaxheri i Personelit i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për ti krye detyrat e punës për pozitën “Zyrtares e Arkivit”, është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, dhe një pretendim ankimore i ankueses është i pa bazuar.

Marr për bazë konstatimin si më sipër dhe duke marr parasysh faktin e majtës së pozitës Zyrtares për Arkiv nga ankuesja, dhe konstatimeve si ne arsyetimin e këtij vendimin Kolegji i Këshillit vendosi si ne dispozitivin e këtij vendim duke refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar në ligj.

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.419/2025

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Përfaqësuesit të ankueses avokatit Latif Hyseni;*
- *Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*